

Shkelu

QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT
NR. 9106/29
D. 2. 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve
Sektori Asistencës dhe Regjistrimit

St
Pe
p
p
p

Nr. 15280/ Prot.

Tiranë, më 31.08/2010

Drejtuar: QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT
TIRANË

Zj. LIZETA BALLA
Shoqëria: "NELSA-LED" (LIZETA BALLA)
Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu,, banesë private, Qesarak, Dajt
TIRANË

Lënda : Kthim përgjigje

Bazuar në shkresën nr. 9106/1, datë 16.08.2010, drejtuar zj. Lizeta Balla dhe në DPT për dijeni, si dhe kërkesës së zj. Lizeta Balla drejtuar DPT më datë 10.08.2010, pasi bëmë verifikimet e të dhënave që administrohen nga ne konstatojmë se:
Ndryshimi i emrit të shoqërisë tuaj nga "LIZETA BALLA" në "NELSA-LED" nuk është pasqyruar në sistemin tonë informatik, sepse të dhënat e ardhura nga QKR-ja janë me gabimin: "ndryshim rrethi pa ndryshuar numrin serial", me CN-398843-05-10, datë 25.05.2010.
Në çështjen me numër CN-398843-05-10, datë 25.05.2010 subjekti ka aplikuar vetëm për deklaram të numrit të telefonit dhe nga QKR-ja i është ndryshuar rrethi duke kaluar nga Qesarakë, Tiranë në Qesarakë, Kolonjë.
Subjekti asnjëherë nuk ka qenë tatimpagues i rrethit Kolonjë, Korçë, e cila duket qartë edhe në Vendimin e Gjykatës, ku selia ka qenë dhe vazhdon të jetë në Tiranë.
Pavarësisht korigjimit të numrit serial nga QKR-ja, ky gabim ka sjellë pasoja dhe ndryshimi i emrit të shoqërisë nuk mund të pasqyrohet në sistemin tonë informatik deri në gjetjen e një zgjidhje teknike ndërmjet dy institucioneve tona.
Shoqërinë "NELSA-LED" e sqarojmë edhe një herë në vazhdim të përgjigjes nr. 13820/1, datë 03.07.2010 se deri në zgjidhjen e këtij problemi, në marrëdhëniet me organet tatimore, Drejtorinë e Thesarit dhe institucioneve të tjera, do të përdorni Ekstraktin e lëshuar nga QKR, i cili është dokument ligjor.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gazmir SPAHIJA